

## **NJOFTIM**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr.87 datë 12.04.2024 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë:

**Personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me angazhim me kohë të plotë, në pozicionin: "Sekretare mësimore" pranë Departamentit të Matematikës, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore**

### **Përshkrimi i vendit të punës**

Kryen regjistrimin e personave të cilët kanë fituar të drejtën për të qenë student. Arkivon dosjet e regjistrimit të studentëve në bazë të vitit dhe programit të studimit. Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori, në lidhje me aktivitetin mësimor-shkencor.

### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- a) Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- d) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- e) Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- f) Të ketë aftësi të mira komunikuese etiko-profesionale, të bashkëpunimit dhe të punës në grup me kolegët dhe eprorët;
- g) Të njohi një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të çertifikuara sipas testeve të njohura nga MASR. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- i) Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore "largim nga puna";
- j) Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin "Isamil Qemali" Vlorë;
- k) Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

## Kritere të veçanta

1. Të ketë arsim të lartë. Preferohen kandidatë që zotrojnë diploma universitare në shkenca ekzakte.
2. Të ketë përvojë pune. Preferohen kandidatë me eksperiencë pune të mëparshme në pozicione të njëjta ose të ngjashme me vendin e punës të shpallur vakant.
3. Të ketë njohuri kompjuterike.
4. Të zotërojë një diplomë të njohjes së gjuhës së huaj.
5. Të kenë aftësi komunikuese dhe për të punuar në grup.

## Dokumentacioni i kërkuar

- a) Letër interesi për pozicionin (formulari i aplikimit gjendet në adresën [www.univlor.edu.al](http://www.univlor.edu.al))
- b) Jetëshkrim/ Curriculum Vitae;
- c) Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- d) Lista e notave të studimeve universitare (origjinal);
- e) Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve apo specializimeve (kopje e noterizuar);
- f) Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar);
- g) Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
- h) Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj (origjinal ose kopje e noterizuar);
- i) Dëshmi e njohjes së kompjuterit (origjinal ose kopje e noterizuar);
- j) Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- k) Vërtetim i gjëndjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin);
- l) Letërnjoftimi ID (fotokopje);

### Shënim:

*Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

## Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Drejtorja e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.

**Aplikim për punësim/pozicioni i punës: "Sekretare mësimore" pranë Departamentit të Matematikës në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore**  
Lagjja "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.

### **Afati për aplikim**

- ✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 15.04.2024 dhe afati përfundon në datën 24.04.2024).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 24.04.2024, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

### **Fazat në të cilën do të kalojë konkurimi**

- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
  - vlerësimi i dosjes parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e arsimimit, përvojës në punë, trajnimet e kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe vlerësimet pozitive;
  - intervista e strukturuar me gojë;

### **Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë**

- Aftësitë komunikuese, bashkëpunuese etj.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 70 pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, e ndarë në: 30 pikë arsimimi, 20 pikë përvojë pune, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.
- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku, me një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe formimi i tyre.

### **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.

**DREJTOR**

**ELOINA TOZAJ**